



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA PËRMET**

**Lënda:** Thirrje për pjesmarrje në konsultim publik me objekt “Menaxhimi i mbetjeve urbane në Bashkinë Përmet”.

**Drejtuar:** Z/Znj \_\_\_\_\_.

*Adresa: Qyteti Përmet.*

*Të nderuar*

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015” Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, amenduar me ligjin nr. 156, datë 10.10.2013, Ligjit nr 107/2014 date 31.07.2014 “Per Planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Vendimit nr 3 date 10.06.2020 te KKT “Për Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Përmet”, VKM nr.175, datë 19/01/2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të mbeteve dhe të Planit Kombëtar të menaxhimit të mbetjeve", Vendim Nr. 575, datë 24.6.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte” VKM nr.418 datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim", Vendim Nr. 319, Datë 31.5.2018 Për Miratimin e masave për Kostot e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, vendim Nr. 660, Datë 31.10.2018 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin mbetjeve të metaleve”, Vendim Nr. 418, Datë 27.5.2020 Për Miratimin e dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035. në zbatim të tyre:

Bashkia Përmet ka për qëllim hartimin e rregullores për menaxhimin e mbetjeve urbane në Bashkinë Përmet, e cila synon të krijojë një mjedis sa më të pastër. Objekt i konsultimit publik do të jetë:

- Analize të detajuar të gjendjes aktuale të shërbimit të grumbullimit të mbetjeve.
- Përcaktimi i orarit të hedhjes së mbetjeve urbane nga familjarët dhe bizneset në PGM.
- Ndarja në burim/grumbulimi i diferencuar i mbetjeve urbane.
- Riciklimi i mbetjeve urbane.

Në këtë kuadër duke qënë se hartimi i kësaj rregullore është i rëndësishëm për publikun kërkojmë pjesëmarrjen Tuaj në këtë konsultim publik për të shprehur mendimet dhe idetë Tuaja në datën 15/09/2022, ora 11.00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë, kat II<sup>te</sup> Bashkia Përmet.

*Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj.*

**KRYETARI BASHKISE**

**Alma HOXHA**

